



**| Parimet Kombëtare për
Drejtësinë Tranzicionale
për grupet e viktimave**

Preambulë

Ne, grupet e viktimave të Kosovës, që **synojmë** të krijojmë procese kumtimplota dhe të qëndrueshme të drejtësisë tranzicionale me në qendër viktimat në vendet tona dhe në rajonin e gjerë, **njohim**:

- vuajtjet, vështirësitë dhe padrejtësitë e përjetuara nga viktimat në tërë rajonin pas konflikteve të kaluara,
- shkarjet e mëdha që kanë shkaktuar përçarje në vendet tona, si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- nevojën urgjente për:
 - » të korrigjuar dëmin e shkaktuar nga të gjitha viktimat në rajon dhe
 - » tejkaluar ndarjet e së kaluarës që vazhdojnë të prekin rajonin tonë,
 - » përcaktimin e garancive për ta parandaluar përsëritjen dhe vuajtjet që sjellë konflikti.

Të vendosur për ta mbrojtur dinjitetin e të gjitha viktimave dhe të mbijetuarve të së kaluarës sonë të dhimbshme dhe për të vepruar gjithmonë në interesin e tyre më të mirë.

Të shqetësuar nga keqtrajtimi i vazhdueshëm i viktimave dhe të mbijetuarve, dhe manipulimet e së kaluarës, dhe **duke theksuar**:

- zërat e padëgjuar të viktimave nga grupet e marginalizuara, veçanërisht minoritetet, gratë dhe të rinjtë,
- mbizotërimin e narrativave të njëanshme dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes,
- mundësinë e përhershme për dhunë dhe konflikt të vazhdueshëm.

Në përputhje me rrethanat, ne i miratojmë këto parime për krijimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale me në qendër viktimat në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe:

Angazhohemi për t'i zbatuar këto parime dhe për t'i respektuar vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë për të siguruar që interesat e viktimave dhe të mbijetuarve të mbrohen dhe të mos dëmtohen.

U bëjmë thirrje akterëve politikë dhe publikë që t'u përmbahen këtyre parimeve dhe t'i ruajnë vlerat dhe standardet e tyre përkatëse.

Marrim përsipër të veprojmë me kujdesin e duhur, profesionalizmin dhe transparencën në rrugën tonë të ndjekjes së parimeve, dhe

Inkurajojmë akterët politikë dhe publikë të veprojnë njëjtë kur kanë të bëjnë me të kaluarën, dhe veçanërisht në lidhje me diskursin dhe veprimet e tyre me viktimat.

Diskursi publik i bazuar në narrativa të njëanshme nuk duhet të promovohet

Narrativa që lidhet me trashëgimitë e luftës duhet të ndërtohet bazuar në **prova dhe fakte** dhe duhet të jetë e **paanshme dhe gjithëpërfshirëse**. Narrativa e luftës është rrëfim i të gjithëve, ndaj secili duhet të bëjë pjesën e tij që lufta të mësohet dhe të mbahet mend siç duhet, duke nderuar kështu çdo viktimë **pa dallim**. Kjo duhet të fillojë nga viktimat dhe përfaqësuesit e tyre për të vazhduar me institucionet dhe palët përkatëse.



Çdo viktime duhet t'i njihet statusi

Sakrifica e çdo viktime të luftës duhet të njihet dhe të respektohet, por fatkeqësisht në Kosovë nuk po ndodhë kjo. Të gjitha grupet synojnë t'i minimizojnë vuajtjet dhe humbjet e njëri-tjetrit. Secila viktimë është viktimë, kështu që mes anëtarëve të familjes dhe përfaqësuesve të viktimave, llogaritjet nuk duhet të bëhen në bazë të numrit të humbjeve apo përkatësisë etnike të viktimave. Duke mos qenë të njëanshëm dhe mono-etnik, ne **nderojmë çdo viktimë individuale** dhe kështu përfshirja e të gjitha viktimave pa asnjë diskriminim i **fuqizon** më tej viktimat, të mbijetuarit dhe familjet e tyre.



Duhet të sigurohet një qasje me bazë gjinore në proceset e DT-së

Në proceset e ndërtimit të paqes, **gratë duhet të jenë shumë të përfshira** pasi ekziston nevoja për një qasje me bazë gjinore ndaj drejtësisë tranzicionale dhe kjo duhet bërë për të siguruar që të gjitha proceset të jenë sa më gjithëpërfshirëse. Për më tepër, ekziston nevoja që të ketë barazi veçanërisht në përfaqësimin e grupeve të viktimave, që do të thotë se përfshirja e grave nuk duhet të jetë vetëm në nivel pjesëmarrës, por edhe në mënyrë thelbësore si në **rolet udhëheqëse në proceset e ballafaqimit me të kaluarën**. Përveç kësaj, për viktimat e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, të përdorura si armë lufte, duhet të ndalet stigmatizimi dhe të ketë programe dhe shërbime konkrete, me bazë gjinore, ku sidomos **gratë duhet të përfitojnë nga barazia dhe pranimi**.



Përkujtimi dhe dokumentimi i së kaluarës duhet të jenë procese gjithëpërfshirës

Shumica e viktimave kujtojnë dhe i përkujtojnë ngjarjet nga perspektiva e tyre mono-etnike. Memoria publike duke përfshirë dokumentimin, memorializimin, përkujtimin dhe format e tjera të memories publike duhet t'u **takojnë të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë** pa asnjë diskriminim sa i përket kategorisë së viktimave dhe prejardhjes së tyre etnike, kjo pasi që në Kosovë pjesa më e madhe e memories publike karakterizohet nga një qasje e njëanshme dhe paragjyquese.



Aktivitetet e përbashkëta avokuese të grupeve të viktimave duhet të intensifikohen për qëllime dhe kauza të përbashkëta

Grupet e viktimave nuk i artikulojnë së bashku nevojat dhe kërkesat e tyre, ka një ndjenjë sikur ato janë të ndara dhe nuk e kuptojnë rëndësinë e **bashkimit në avokim**, si një mjet i fuqishëm në raport me organet institucionale dhe për shoqërinë në përgjithësi. Ka mungesë përfshirjeje dhe gjithashtu mungesë të aktiviteteve gjithëpërfshirëse avokuese. Duhet të realizohen **veprime të përbashkëta avokuese** në mënyrë që të institucionalizohen kauzat **përmes presionit publik**.



Grupet e viktimave nuk duhet të instrumentalizohen

Shumë shpesh, organizata të ndryshme dhe grupe viktimash instrumentalizohen nga akterët politikë për përfitime në shkallë të vogël. Përfaqësuesit e organizatave të viktimave duhet të veprojnë me **përgjegjësi** kur i përfaqësojnë interesat e grupeve të viktimave duke shmangur çdo manipulim që mund të vijë nga faktorë të jashtëm sepse kjo dëmton reputacionin e tyre dhe punën e tyre për nevojat e viktimave. Për më tepër, çdo veprim/iniciativë e grupeve të viktimave duhet të jetë **transparente dhe gjithëpërfshirëse**, në mënyrë që viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre të përfshihen dhe të informohen në mënyrë të drejtë në lidhje me çdo proces në lidhje me to si viktimat.




Të gjitha proceset e Drejtësisë Tranzicionale dhe Ballafaqimit me të Kaluarën duhet të kenë në fokus viktimat

Të gjitha aktivitetet dhe iniciativat për ballafaqim me të kaluarën në lidhje me viktimat duhet t'i kenë ato në **qendër të proceseve**. Pjesëmarrja e tyre, kryesisht për hirë të shifrave, nuk duhet parë si e tillë pasi **kontributi i tyre është thelbësor** në të gjitha proceset e ballafaqimit me të kaluarën. Asnjë proces i ballafaqimit me të kaluarën nuk mund të planifikohet pa një **pjesëmarrje dhe qasje të përqendruar te viktimat**.



Të gjitha viktimat duhet të trajtohen me dinjitet

Të gjitha viktimat duhet të trajtohen me **dhembshuri dhe respekt për dinjitetin e tyre**. Organizatat e viktimave duhet të veprojnë me ndjeshmëri dhe korrektësi ndaj të gjitha grupeve të viktimave dhe t'i pranojnë vuajtjet e tyre në mënyrë që stigmatizimi dhe paragjykimet ekzistuese të eliminohen. Çdo viktimë kërkon **llogaridhënie, njohje të statusit dhe kompensim** për vuajtjet e veta duke e vënë **dinjitetin e tyre në qendër** të projekteve dhe aktiviteteve të ballafaqimit me të kaluarën.



Duhet të sigurohet mbrojtja e identitetit dhe privatësisë së viktimave

Ekziston një frikë në mesin e grupeve specifike të viktimave se historitë e tyre mund të bëhen publike dhe integriteti i tyre personal do të rrezikohet kur u zbulohet identiteti. Duhet të merren **masa mbrojtëse për privatësinë**, veçanërisht ndaj konfidencialitetit të individëve që rrëfejnë historitë e tyre për përvojat e luftës. Pa pëlqimin e dhënë nga viktimat, **identiteti i tyre duhet të mbrohet me çdo kusht** që do të thotë se nuk duhet të bëhet asnjë publikim i informatave në lidhje me ta pa pëlqimin paraprak. E drejta për privatësi është e drejtë themelore dhe si e tillë duhet respektuar.



Të drejtat e viktimave dhe barazia në drejtësi duhet të promovohen

Është e rëndësishme që viktimat të njihen si persona me **të drejta dhe privilegje** dhe askujt nuk duhet t'i mohohen të drejtat që i përkasin në vendin ku jeton. **Të drejtat e viktimave duhet të njihen dhe të promovohen** nga organizatat e viktimave pa diskriminim në asnjë aspekt, në përputhje me konventat dhe praktikat ndërkombëtare. Të drejta të tilla si e drejta për të ditur fatin e viktimave dhe anëtarëve të familjeve të tyre, drejtësia e barabartë dhe reparacionet, duhet të promovohen pa asnjë dallim.

10

Duhet të sigurohet integriteti dhe besimi i ndërsjellë

Është e një rëndësie të madhe që organizatat dhe përfaqësuesit e tyre të veprojnë me **integritet dhe të ndërtojnë besim të ndërsjellë**, ashtu që vetëm pas krijimit të një marrëdhënieje të drejtë me viktimat, të **rritet përfshirja** e tyre në proceset e drejtësisë tranzicionale. Në përgjithësi, viktimat janë stigmatizuar nga publiku i gjerë dhe nuk kanë përfaqësim të besueshëm, prandaj kanë frikë dhe ngurrojnë të marrin hapin dhe t'u drejtohen organizatave apo institucioneve përkatëse.



Duhet të rritet bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirja ndërmjet organizatave të viktimave

Organizatat dhe përfaqësuesit e viktimave duhet të krijojnë një **mjedis gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues** për të gjithë anëtarët e familjeve të viktimave që vijnë nga komunitete të ndryshme. Organizatat e viktimave duhet t'i eliminojnë dallimet e tyre, së pari midis organizatave brenda të njëjtit grup viktimash që vijnë nga cilido komunitet dhe më tutje edhe si një grup i përgjithshëm viktimash. Kjo duhet të bëhet duke **rritur mirëkuptimin, pranimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet të gjithëve.**

12

Duhet të garantohen të drejtat për ndihmë efektive juridike për të gjitha viktimat

Çdo viktimë e ka të drejtën për **mjete efektive juridike, duke përfshirë rehabilitimin dhe kompensimin**, pasi si viktimat ato kanë pësuar dëmtime mendore, fizike, emocionale dhe shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Grupet e viktimave duhet të insistojnë në **mekanizma të rehabilitimit, programe të kompensimit** dhe masa që përfshijnë një qasje holistike dhe të integruar me shërbime të specializuara. Në praktikë ligji duhet të zbatohet në një formë gjithëpërfshirëse për **të gjitha viktimat** që vijnë nga përkatësi të ndryshme etnike.

13

Të gjitha viktimat duhet të informohen për të drejtat e tyre

Viktimat duhet të **informohen vazhdimisht** për rolet dhe të drejtat e tyre për çdo proces që lidhet me to. Atyre duhet t'u sigurohet informacioni përkatës dhe të sigurohet se e kuptojnë informacionin, rolet dhe të drejtat e tyre. Për më tepër, atyre duhet t'u jepen edhe detaje përkatëse, nëse nevojitet sqarim.

14

Fajësimi dhe atribuimi i krimeve të luftës nuk duhet të bëhet kolektivisht

Për viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre, është shumë e rëndësishme të **luftohet mosndëshkimi** dhe të vazhdohet të kërkohet drejtësi për autorët që kanë kryer krime lufte, në mënyrë që ata të **mbahen përgjegjës**. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme të mos fajësohet pjesërisht e as tërësisht një grup etnik apo komunitet për këto krime. Krimet duhet t'i atribuohen individëve ose institucioneve që kanë kryer ose urdhëruar krime, ashtu siç nënkupton edhe përgjegjësia penale. **Krimet nuk duhet t'i atribuohen kolektivisht** një komuniteti etnik sepse kjo e pengon krijimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë.

15

Gjuha e urrejtjes duhet luftuar dhe eliminuar

Përfaqësuesit e grupeve të viktimave vazhdojnë të përdorin gjuhë të urrejtjes plot nacionalizëm dhe diskurs të njëanshëm për shkak të përkatësisë së tyre etnike ose asaj se çfarë kanë humbur. Gjuha e urrejtjes **është kërcënim për funksionimin normal dhe demokratik** të shoqërive dhe veprimet në të cilat përdoret gjuha e urrejtjes ndaj një grupi ose një viktime mund të çojnë në përshkallëzimin e situatës mes tyre, sidomos në nxitjen e diskriminimit. Çdo humbje dhe çdo viktimë duhet të **nderohet dhe respektohet si e tillë.**

16

Ky projekt është një iniciativë e përbashkët e zbatuar në Kosovë, Serbi dhe Maqedoni të Veriut, nga Lëvizja PAX Peace, Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ), Integra, Iniciativa e Re Sociale (NSI), Nismat Qytetare (CI) dhe Aksioni Paqësor (PA), mbështetur nga Bashkimi Evropian





Iniciativat Qytetare (Gradjanske inicijative): Iniciativat Qytetare është një organizatë e shoqërisë civile e cila për tashmë 25 vjet punon në edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, demokracinë, shoqërinë civile dhe në atë se si të jenë qytetarë aktivë dhe të barabartë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. Vizioni i organizatës "Iniciativat Qytetare" është një shoqëri e drejtë e qytetarëve të vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe rolin e tyre, shoqëri aktive dhe e zëshme në dialog të vazhdueshëm me një shtet të hapur dhe të përgjegjshëm <https://www.gradjanske.org>



Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (International Center for Transitional Justice ICTJ): ICTJ rpunon krah për krah me viktimat për të arritur njohjen dhe korrigjimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, për të kërkuar llogari nga ata që janë përgjegjës, për të reformuar dhe ndërtuar institucione demokratike dhe për të parandaluar përsëritjen e dhunës ose shtypjes. <https://www.ictj.org>



OJQ Integra: Misioni i Integra-s është të ndihmojë zhvillimin e Kosovës, veçanërisht në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe integritimit, duke trajtuar dhe promovuar rrëfime dhe përvoja të komuniteteve të marginalizuara, duke kontribuar kështu në proceset demokratike, ndërtimin e besimit dhe bashkëjetesës paqësore. <https://www.ngo-integra.org>



Iniciativa e Re Sociale (NSI): është një organizatë e shoqërisë civile që fuqizon komunitetet joshumicë për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës dhe rrit besimin në mes të komuniteteve duke i mbështetur ata që të merren me të kaluarën dhe të normalizojnë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. <https://www.newsocialinitiative.org>



Aksioni Paqësor (Mirovna akcija): Aksioni Paqësor është një organizatë jofitimprurëse e aktivistëve që punon në ndërtimin e paqes dhe promovimin e kulturës së mosdhunës përmes inicimit dhe edukimit të dialogut konstruktiv, duke u marrë me të kaluarën, arsimin e integruar dhe bashkëpunimin rajonal. <https://mirovnaakcija.org>



PAX: PAX është organizata më e madhe e paqës në Holandë. Ajo punon për të mbrojtur civilët nga aktet e luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur dhe për të ndërtuar paqen gjithëpërfshirëse. PAX punon në zona konflikti në mbarë botën me partnerë lokalë dhe njerëz të cilët, ngjashëm, besojnë se secili ka të drejtën për një jetë dinjitoze në një shoqëri paqësore. <https://www.paxforpeace.nl>



Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit "**Fuqizimi i zërave gjithëpërfshirës të viktimave, transformimi i narrativave**", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e konsorciumit të projektit, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.